# DËSHMI ARKIVI

**A-462464**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Në 2027 nis ndërtimi i hekurudhës Vorë-Hani i Hotit, Karakaçi: Në nëntor shpallet fituesi për Durrës-Rrogozhinë |
| ADRESA | `https://versus.al/ekonomi-mjedis/ne-2027-nis-ndertimi-i-hekurudhes-vore-hani-i-hotit-karakaci-ne-n-i47028` |
| BURIMI | versus.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:46:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 15:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a29905c5205f9fefaee6c9719da557b05c58044e08e3a7ee681666e4d04146c0` |
| TEKSTI | `dd8c54be09dddc2c99705edf5538f22b0e1ae91963c55edb1f5b2f1b99fb3269` |
| PAMJA | `3006507aa7ea0a6e7c81e2af8d7eac1f6dfb84ea517ec017282611b01830b32b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `73d6830cef2e3fe24ecf3e983d22688e718588052b040461ff837a84c29a3c71` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/73d6830cef2e3fe24ecf3e983d22688e718588052b040461ff837a84c29a3c71`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[“Na kanë bërë shumë gjëra o shpirt"/ Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi mbi 500 mesazhe në 2 muaj në Signal. Shefja e SHISH i dha materiale sekrete, merret në pyetje nesër në GJKKO!]

23 Shtator 2026, 13:50

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

- 
- 
- 
- 




- Politikë
- aktualitet
- MAGAZInë
- bota
- opinion
- ekonomi & MJEDIS
- VIDEO


- 
- 
- 
- 

Created and monetized by

EKONOMI & MJEDIS / 23 Shtator 2026, 17:40

# Në 2027 nis ndërtimi i hekurudhës Vorë-Hani i Hotit, Karakaçi: Në nëntor shpallet fituesi për Durrës-Rrogozhinë

Karakaçi deklaroi se është drejt përfundimit edhe gara për ndërtimin e hekurudhës Vorë-Hani i Hotit. Investimi kap vlerën rreth 360 milionë euro dhe punimet pritet të nisin në fillim të vitit 2027.

Shkruar nga Versus



Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi, ka deklaruar se projektet infrastrukturore të lidhura me Korridorin VIII dhe Korridorin Adriatiko-Jonian po avancojnë, ndërsa disa prej tyre kanë hyrë në fazën përmbyllëse të garave.

Karakaçi bëri të ditur se gara për ndërtimin e hekurudhës Durrës-Rrogozhinë është drejt përfundimit dhe brenda muajit nëntor pritet të shpallet kompania fituese.

"Për sa i përket Korridorit VIII, tashmë është në përmbyllje gara për hekurudhën Durrës-Rrogozhinë dhe brenda muajit nëntor pritet shpallja e fituesit", tha ministri.

Ai shtoi se vijon puna për zgjerimin e korridorit Elbasan-Qafë Thanë, ndërsa segmentet e para të bypass-it të Elbasanit janë kontraktuar dhe kanë nisur punimet.

Sa i përket Korridorit Adriatiko-Jonian, Karakaçi deklaroi se është drejt përfundimit edhe gara për ndërtimin e hekurudhës Vorë-Hani i Hotit. Investimi kap vlerën rreth 360 milionë euro dhe punimet pritet të nisin në fillim të vitit 2027.

"Për sa i përket Korridorit Adriatiko-Jonian, edhe këtu jemi në fazën përmbyllëse të garës për ndërtimin e hekurudhës Vorë-Hani i Hotit. Investim rreth 360 milionë euro që pritet të fillojë nga ndërtimi në fillim të vitit 2027", deklaroi Karakaçi.

Ministri foli edhe për autostradën Adriatiko-Joniane, duke u ndalur te segmenti Murriqan-Balldren, për të cilin po përgatitet studimi inxhinierik me fonde grant nga Bashkimi Europian. Dokumenti pritet t'i dorëzohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në janar 2027.

Ndërkohë, sipas Karakaçit, vijon puna për finalizimin e kontratës për autostradën Milot-Balldren dhe për projektin teknik përfundimtar.

Në kushtet e diskutimeve të fundit rreth projektit, ministri tha se dokumentacioni do të publikohet në platformën "Flamingo Mirror", me qëllim që të mundësohet verifikimi nga të interesuarit.**/Versus.al**

Poll




EKONOMI & MJEDIS

[Kreditë për shtëpi dhe sulmet kibernetike/ Banka e Shqipërisë paralajmëron: Sytë duhen mbajtur hapur!]

23 Shtator 2026, 17:23

^ekstrakti^





EKONOMI & MJEDIS

[Kostoja e shëndetit, 8% e shqiptarëve nuk përballojnë ekzaminimet, e dyta më e lartë në Europë]

23 Shtator 2026, 08:02

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Tatimet me "dorë të hekurt" ndaj bizneseve debitore, propozohet mbledhje me forcë e detyrimeve të parapagimit të tatimit mbi fitimin]

22 Shtator 2026, 17:15

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Paradoks popullsie në Shqipëri, lindin më shumë djem, por në vend ka 28 mijë femra më shumë]

22 Shtator 2026, 13:24

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Hetimet dhe sekuestrimit e SPAK ulin kërkesën për apartamente, kush po blinte?!]

22 Shtator 2026, 08:05

^ekstrakti^




EKONOMI & MJEDIS

[Çmimet e shtrenjta të ushqimeve, si e arriti dhe e kaloi Shqipëria mesataren e BE?]

21 Shtator 2026, 08:02

^ekstrakti^




EKONOMI & MJEDIS

[Çfarë po ndodh me monedhat e huaja? Ja sa shitet dhe blihet euro dhe dollari]

20 Shtator 2026, 08:16

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Bordi i Transparencës cakton çmimet e reja për naftën dhe benzinën]

19 Shtator 2026, 10:17

^ekstrakti^

[Të fundit]



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.